



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:176745

Datë: 11.01.2022

Numri i dokumentit: 02593624

**C.nr.1241/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, në çështjen kontestimore të paditëses L. K. K. nga Gj., të cilën me autorizim e përfaqëson, av. F. S. nga Gj., ndaj të paditurës Komuna e Gj. – D. për Sh. dhe M.e S., për anulimin e pjesërishëm të vendimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik /për shkak të Pandemisë Covid-19/, më datë 12.01.2022, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.**Aprovohet kërkesëpadia e paditëses L. K. K. nga Gj. dhe anulohet pjesërisht Vendimi i Komisionit të Ankesave, me numër ....., i dt. 14.09.2021 dhe Vendimi me numër .....04-...../21, i dt. 31.08.2021, lëshuar nga D. për Sh. dhe M. S., edhe atë vetëm në pjesën sa i përket pranimit të kundërkandidatëve për pozitën infermier/e në QKMF „ N. R., në Gj., në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij vendimi, nën pasojat ligjore të përmbarimit të dhunshem ligjor.

**II.**Detyrohet e paditura D. për Sh. dhe M. S. që të shpallë konkurs të ri, në afat prej 8 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**III.**Paditësja lirohet nga shpenzimet e procedurës kontestimore.

**IV.**Detyrohet e paditura që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 374.00€, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij vendimi, nën pasojat ligjore të përmbarimit të dhunshem ligjor.

**A R S Y E T I M**

**1.Jurisdiksioni i gjykatës:**

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështje dhe bazuar në nenin 1, lidhur me nenin 49 të LPK-së dhe nenit 11 të Ligjit për Gjykatat e Kosovës, konstatoi se çështja bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje. Kompetenca lëndore është përcaktuar në bazë të nenit 17.2 dhe 29 të LPK-së, ku thuhet se “*vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata dhe se gjykata gjatë gjithë procedurës duhet të kujdeset për kompetencën e saj lëndore*”, prandaj, pasi që kemi të bëjmë me një kontest me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia e punës, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin

e kësaj çështjeje. Kompetenca territoriale është përcaktuar konform nenit 49 të LPK-së, ku shprehimisht është përcaktuar se *“Në qoftëse në kontetet nga marrëdhënia e punës paditës është punëtori, për gjykim është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht gjykata në territorin e së cilës puna është dashur të kryhet si dhe gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës”*.

## **2.Dispozitat materiale të zbatueshme:**

Meqenëse kontesti i inicuar nga paditësja karakterizohet si marrëdhënie juridiko-civile e natyrës së punës, me rastin e vendosjes meritorie të saj, Gjykata ka zatur nenin 78 të Ligjit të Punës /Ligji nr. 03/ L-212, 1 nëntor 2010/, pastaj nenin 7, paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i dt. 19.10.2017, i nxjerrur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe nenin 68. Pika 7 i Ligjit për Zyrtarët Publikë/ *Ligji nr. 06/L-114 2 shkurt 2019/* të cilat dispozita janë në harmoni të plotë me dispozitat kushtetuese të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, edhe atë nenet 24 dhe 49 dhe janë në frymën e nenit 14 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar, më datë 04 Nëntor 1950.

## **3.Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve:**

Paditësja L. K. K. nga Gj., përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, avokatit F.S. nga Gj., në këtë Gjykatë ka ushtruar padi, e të cilën e ka plotësuar në seancën e fundit mbi shqyrtimin kryesor dhe ka kërkuar nga Gjykata që të anulohet Vendimi i Komisionit të Ankesave, me numër ....., i dt. 14.09.2021 dhe Vendimi me numër ...../21, i dt. 31.08.2021, i lëshuar nga D. për Sh. dhe M. S., edhe atë vetëm në pjesën sa i përket pranimin të kundërkandidatëve për pozitën infermier/e në QKMF ,, N. R., në Gj. dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 8 ditësh të rishpallë konkurs të ri si dhe kompenzimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Paditësja, më tej ka theksuar se vendimet e lartcekura, të marra nga ana e të paditurës, janë vendime kundërligjore dhe në kundërshtim me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i dt. 19.10.2017, pasi që komisioni i formuar është përbërë prej pesë anëtarëve, edhe atë një vozitës, një juriste, një stomatolog dhe dy doktoresha, kurse në Udhëzim Administrativ thuhet se komisioni duhet të jetë i përbërë prej kryetarit dhe dy anëtarëve të komisionit, të cilët kanë kualifikim universitar dhe të jenë të balancuar në aspektin gjinor dhe etnik dhe aty ku është e mundshme, së paku njëri nga anëtarët duhet të jetë i të njëjtit profesion me pozitën e shpallur, e që e paditura këtë ka mundur ta bëjë, duke marrë parasysh se konkursi publik ka qenë i shpallur për pozitën infermier/e dhe se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, ku paditësja ka aplikuar, ka kuadër të mjaftueshëm të infermierëve, që të jenë anëtarë të komisionit, e jo të mosrespektohet as numri i anëtarëve të komisionit, nga 3 në 5, si dhe kualifikimi i tyre, meqë, siç u cek më lart, në intervistim dhe vlerësim të kandidatëve ka marrë pjesë edhe personi me pozitën e punës së vozitësit.

Pas pranimin të padisë, kjo Gjykatë, duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të ushtrojë përgjigje lidhur me pretendimet e saj. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigjen në padi dhe gjatë shqyrtimeve kryesore e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, ngase, sipas tij, procedurat përzgjedhëse sipas konkursit të publikuar për këtë vend pune kanë qenë në rregull dhe janë

zhvilluar konform rregullativës ligjore për punësim dhe se vendimet e marra janë vendime ligjore.

#### **4.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor:**

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë në këtë çështje juridiko-civile, Gjykata bëri administrimin dhe analizimin e provave materiale, edhe atë: Diploma me nr. ..../19, e dt. 01.07.2019, e lëshuar nga Kolegji “AAB” në P., në emër të paditëses; Licenca e punës, e lëshuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë të Kosovës; Kontrata e punës për kohë të caktuar, e lëshuar në emër të paditëses, nga Caritas Kosova; Kontrata tjetër, e lëshuar nga C... K....., në emër të paditëses, e dt. 16.03.2016; Vërtetimi mbi marrëdhënien e punës, i dt.03.09.2021, lëshuar nga C.... K.....; Vërtetimi nr. 04-....., i dt. 23.12.2019, lëshuar nga Q. K. e M. F. në Gj.; Kopja e ankesës, pa datë dhe e pa nënshkruar, e pranuar më datë 06.09.2021 nga e paditura; Formulari për kërkesë apo ankesë, i dt. 06.09.2021; Vendimi nr. ...., i dt. 14.09.2021, lëshuar nga Drejtoria e Sh. dhe M. S.; Vendimi nr...../21, i dt. 31.08.2021, lëshuar nga D. e Sh. dhe M. S.; Vendimi nr. ...., i dt. 14.09.2021, lëshuar nga D. e Sh. dhe M. S.; Kopja e konkursit publik dhe kërkesa për shpalljen e konkursit publik për plotësimin e vendeve të lira të punës, e protokoluar me numër ....., e dt. 08.06.2021, lëshuar nga Q. K. e M. F. “Dr. N.R.” në Gj. dhe Vendimi me numër.....i dt. 30.07.2021, lëshuar nga DSHMS.

#### **5.Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës:**

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqjese dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga të cilat ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar me ligj dhe se paditësja ka interes juridik për ushtrimin e padisë në gjykatë dhe mbrojtjen e të drejtës së saj subjektive, si prezumim procedural i cili duhet të plotësohet konform nenit 2.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore /Ligji nr. 03/ L-006 30 qershor 2008/, në të cilën dispozitë është përcaktuar se “Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë”, meqë ka qenë pjesëmarrëse dhe kandidate në Konkursin publik, të datës 14.06.2021, të shpallur nga e paditura. Gjykata ka vërtetuar se e paditura, në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtatë Publikë /Ligji nr. 06/L-114, i datës 02.02.2019/, ka shpallur konkurs publik për një numër të caktuar vendesh dhe pozitash të punës, në mesin e të cilave janë edhe 7 pozita për infermier/e në Q.K. të M. F. “Dr. N.R.” në Gj. dhe njëri pej tyre për punë në AMF-V. e Zh. dhe se e paditura, përmes Vendimit nr. ..../21, të datës 30.07.2021, ka formuar komisionin për përzgjedhje “ad hoc”, në përbërje të Dr. S. S. Dr. F. S., Dr. S. S., A. Sh. - zyrtare ligjore dhe N. O. - vozitës. Këto fakte janë vërtetuar nga Kopja e konkursit publik, të datës 14.06.2021 dhe kërkesa për shpalljen e konkursit publik për plotësimin e vendeve të lira të punës, e protokoluar me numër ....., e dt. 08.06.2021, lëshuar nga Q. K. e M. F. “Dr. N. R.” në Gj. si dhe Vendimi nr. ...., i datës 30.07.2021, mbi formimin e komisionit përzgjedhës. Është jokontestues fakti se paditësja i ka plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veqanta të konkursit publik, ngase këto fakte konfirmohen nga vet Diploma me nr. ..../19, e dt. 01.07.2019, e lëshuar nga Kolegji “...” në P., në emër të paditëses; Licenca e punës, e lëshuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë të Kosovës; Kontrata e punës për kohë të caktuar, e lëshuar në emër të paditëses, nga C.... K.....; Kontrata tjetër, e lëshuar nga C.....K..., në emër të paditëses, e dt. 16.03.2016;

Vërtetimi mbi marrëdhënien e punës, i dt.03.09.2021, lëshuar nga C... Kosova; Vërtetimi nr. ...., i dt. 23.12.2019, lëshuar nga Q. K. e M. F. në Gj. dhe meqë këto fakte nuk janë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, atëher të njejtat nuk janë arsyetuar nga ana e Gjykatës.

Gjykata ka vërtetuar faktet se pas mbajtjes së intervistimit me shkrim dhe me gojë, të datës 09.08.2021, respektivisht të datës 25.08.2021, D. e Sh. dhe M. S. me njoftimin e marrë, me nr. .... /21, të datës 31.08.2021, ka njoftuar kandidatët të cilët kanë marrë më së shumti pikë nga dy testet intervistuese, ku paditësja është radhitur në vendin e 18-të, me 180 pikë, fakt që e konfirmon vetë njoftimi nr. .... /21, i datës 31.08.2021. Për shkak të pikëve të pamjaftueshme për t'u përzgjedhur si infermiere dhe e pakënaqur me një njoftim të tillë, paditësja iu ka drejtuar me ankesë Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gj. dhe se e paditura, duke e shqyrtuar ankesën e paditëses, të njëjtën e ka hudhur poshtë si të papranueshme, me vendimin e saj nr. ...., të datës 14.09.2021 /*në vend se të refuzojë ankesën si të pathemeltë apo ta aprovojë si të bazuar konform dispozitave ligjore të Ligjit të Procedurës Administrative, ngase hudhja e një parashtrese apo një mjeti juridik si preziumim procedural mund të bëhet vetëm kur ajo është e palejuar, e pasafatshme dhe e paraqitur nga personi i paautorizuar, e jo edhe kur ajo është e themeltë apo e pathemeltë, ngase themelësia e një mejeti juridik është prezumim materialo juridik dhe për të duhet të vendoset në mënyrë meritore/*, fakte këto që nuk kanë qenë kontestuese në mes të palëve, ngase konfirmohen nga vetë kopja e ankesës dhe formulari i ankesës apo parashtresës, e datës 06.09.2021 dhe Vendimi nr. ...., i datës 14.09.2021 dhe me këtë Gjykata konstaton se pala paditëse i ka shtjerrë të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative dhe se konform nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës /Ligji nr. 03/ L-212, 1 nëntor 2010/, paditësja gëzon mbrojtje gjyqësore. Në nenin 79 të Ligjit është përcaktuar se „Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente .

Gjykata konkludon se dispozita ligjore e Ligjit për Zyrtarët Publikë, neni 68 pika 7, në mënyrë decisive ka përcaktuar përbërjen e komisionit përzgjedhës, respektivisht është përcaktuar se “Komisioni i përzgjedhjes është ad hoc, themelohet nga organi emërtues dhe përbëhet nga të paktën 5 persona, ku të paktën tre (3) prej tyre janë profesionistë të fushës në të cilën bëhet vlerësimi i kandidatëve, një (1) është profesionist në fushën e përzgjedhjes të burimeve njerëzore dhe një (1) tjetër është përfaqësues i NJBNJ. Komisioni i përzgjedhjes themelohet për çdo grup apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi”.

Lidhur me konfirmimin e pozitave të anëtarëve të komisionit përzgjedhës, respektivisht të anëtarit të komisionit N. O., për të cilin paditësja pretendon se është vozitës dhe se me këtë pozitë nuk ka mundur të jetë anëtar i komisionit, Gjykata, me urdhëresë iu ka drejtuar të paditurës për konfirmimin e pozitës së tij, por që një urdhëresë të tillë të gjykatës e paditura nuk e ka përfillur, edhe pse ka qenë e detyruar, andaj, në mungesë të kësaj prove materiale, gjykata ka zbatuar parimin e barrës së provave dhe me këtë Gjykata ka konstatuar se fakti i pretenduar i paditëses është pohuar nga e paditura në heshtje me mosdorëzimin e provës materiale lidhur me pozitën e anëtarit intervistues, N. O., pasi që një mundësi e tillë për

gjykatën është përcaktuar në nenin 322.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore /Ligji nr. 03/L-006, 30 qershor 2008/, ku në mënyrë shprehimore është paraparë se *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa në nenin 322.2 të të njëjtit ligj, thuhet *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Poashtu, neni 322.3 i LPK-së përcakton se *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”* dhe me këtë gjykata vërteton se përzgjedhja e komisionit të caktuar nga ana e të paditurës nuk ka qenë në përbërje të rregulltë dhe me këtë janë cenuar dispozitat ligjore nga neni 68 pika 7 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, pasi që në komision në cilësi të anëtarit është caktuar N. O., vozitës i Autoambulancës së QKMF-së “Dr. N. R.” në Gj. dhe se konform nenit 7, paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ, nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i dt. 19.10.2017, i nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mënyrë decidive është përcaktuar se *“Komisioni nga paragrafi i këtij neni përbëhet nga Kryetari i Komisionit dhe 2 anëtarë të cilët kanë kualifikim universitar si dhe të jenë të balancuar në aspektin gjinor dhe etnik. Aty ku është e mundshme, së paku njëri nga anëtarët duhet të jetë i të njëjti profesion me pozitën e shpallur”*, e siç konstatohet në konkursin publik, pozita e shpallur është për Infermiere dhe se në komision nuk ka pasur anëtarë përzgjedhës me pozitën e shpallur për këtë pozitë, edhe pse QKMF “Dr. N. R.” në Gj., ka pasur staf të mjaftueshëm të infermierëve për të qenë anëtarë komisioni.

Andaj, Gjykata ka vendosur si në pikën e parë të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, duke anuluar pjesërisht Vendimin e Komisionit të Ankesave, me numër ....., i dt. 14.09.2021 dhe Vendimin me numër ....., i dt. 31.08.2021, lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, edhe atë vetëm në pjesën sa i përket pranimin të kundërkandidatëve për pozitën Infermier/e në QKMF “Dr. N. R.” në Gj., pasi që komisioni përzgjedhës i të paditurës nuk është përzgjedhur konform dispozitave ligjore të Ligjit për Zyrtarët Publikë, respektivisht komisioni nuk është përzgjedhë konform nenit 68 pika 7, pasi që në komisionin përzgjedhës nuk ka të përzgjedhur anëtarë profesionist në fushën e përzgjedhjes së burimeve njerëzore dhe anëtarë nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe as konform rregullave të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i dt. 19.10.2017, i nxjerrur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pasi që në komisioni përzgjedhës nuk ka pasur anëtarë nga lëmia e infermierisë.

Gjykata, vërteton se me këtë vendim të të paditurës, është cenuar rëndë edhe neni 3, 24 dhe 49 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbi barazinë para ligjit dhe mbi të drejtën e punës, pasi që nuk janë respektuar dispozitat e ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe provat tjera materiale të përmendura më lartë, si dhe deklartën e paditëses, por ato ishin irelevante në vendosjen meritore të kësaj çështjeje, ashtu që nuk u arsyetuan veç e veç.

Gjykata vendosi që konform nenit 452.1 të LPK-së, shpenzimet e procedurës kontestimore t'i bartë e paditura dhe e detyroi atë që paditëses t'ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 374.00€, edhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00€, për përfaqësim të avokatit për dy seanca gjyqësore, nga 135.00€ për çdo seancë, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të Aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e ka liruar paditësen nga shpenzimet e procedurës, ngase sipas Udhëzimit Administrativ mbi Unifikimin e Taksave gjyqësore, nr. ...., i datës 22.03.2017, në nenin 8 pika 1.1 është përcaktuar se *“nga pagesa e taksave gjyqësore lirohen: personi i cili parashtron kërkesën që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, përveç kërkesave në të holla”*.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**Gjyqtari**  
**Berat Spahiu**

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:176745  
Datë: 11.01.2022  
Numri i dokumentit: 02593624